

| | |
|---------------------|-------------|
| Numri i lëndës: | 2024:159572 |
| Datë: | 20.02.2025 |
| Numri i dokumentit: | 05964125 |

P.nr. 122/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, në çështjen penale kundër të pandehuri H T nga fsh. G K. K, i akuzuar për shkak të kryerjes së veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par 8 lidhur me par 6 dhe par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, nr PP//II.nr.613/2024, të datës 10.07.2024, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me dt. 20.01.2025 në praninë e Prokurorit se Shtetit Ramiz Buzhala nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit H T, dhe mbrojtësit të caktuar sipas detyrës zyrtare av. Ardian Desku, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar në të njëjtën ditë gjykata shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 22.02.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër:

H T, i lindur me në fshatin G K. K, ku dhe tani banon, nga babai M dhe nëna Z, e gjinisë K, ka të kryer kualifikimin Master i Shkencave L mj, me profesion udhëheqës i diagnostikës në QKMF K, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa martuar, i identifikuar me numër personal, i nacionaliteti shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datën 23.03.2024, rreth orës 16:20, në rrugën magjistrale Pejë-Prishtinë, pikërisht në fshatin Z K K përballë pompës së derivateve DHF, rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 53 dhe nenin 120, lidhur me nenin 255 të ligjit për rregullat e trafikut rrugor, duke vënë në rrezik jeten e njerzve dhe pasurinë, nga pakujdesia edhe pse ka qenë i vetëdijshtë se pasoja e ndaluar mund

të ndodhë si pasojë e veprimit apo mosveprimit të tij, por me menjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai mund ta ndalojë shkaktimin e saj dhe pasoja është shkaktuar, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin të markes VË , me targa të regjistrimit -FP, me ngjyrë të kuqe merr veprim të kthimit majtas nga rruga kryesore për të hyrë në pompën e derivateve në mënyrë të pasigurtë. Ku si pasojë ndeshet me motocikleten të markës Yamaha me targat e regjistrimit ngjyrë hiri të cilën e drejtonte V M me pasagjer A D i cili në momentin kritik ishte në përballëkalim, i cili në pamundësi për ti ikur goditjes pasi distanca ishte e shkurtë me pjesen e perparme ballore të automjetit të tij e ka goditur motocikletën. Si pasojë motociklisti ishte përplasur fillimisht për automjet, duke u rrëzuar përtokë, ndersa pasagjeri në motocikletë shkon zvarrë disa metra, me c' rast perpos dëmeve materiale në motocikletë lëndime të rënda trupore pëson i dëmtuari V M, lëndime të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në Aktekspertizen Mjeko-Ligjore nga Dr.N Ume nr.ref PE-e datës 18.05.2024.

Me cka ka kryer vepër penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 38, 48, 47 dhe 69 dhe 70 dhe nenit 370 par.8 lidhur me par 6 dhe par 1 të KPRK-së nën. par.1.4 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së e:

GJYKON

Të pandehurin H T

I.Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, ku me pëlqimin e të pandehurit dënimimi me burg iu zëvendësua me dënim me GJOBË në vlerë prej pesëqind (500) €, të cilën shumë obligohet që ta paguaj në paguaj me këste në afat prej dy (2) muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duke filluar nga data 01 deri me datën 05, të çdo muaj vijues.

Mundësia e pagesës me këste, do të revokohet nëse i pandehuri nuk e paguan këstin me ko në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehurit nuk dëshirojnë apo nuk mund ta paguajnë gjobën e shqiptuar sipas afatit të dhënë, e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së,

ku një ditë burgim do ti llogaritet në 20 euro të gjobës gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh ditësh, pasi aktgjykimi të merrë formën e prerë.

II.Lirohet: I pandehuri nga shpenzimet për shkak të gjendjes së dobët ekonomike.

III-UDHËZOHEN: palët e dëmtuara A Dnga R Rr. „A B” dhe V M nga R Rr. „Sh M Sh”qe kërkesën pasurore juridike ta realizoi në contest civil.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën, me shenjen nr PP//II.nr. 613/2024 të datës 10.07.2024 kundër të pandehurit H T, akuzuar për shkak të kryerjes së veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par 8 lidhur me par 6 dhe par.1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës qe pas administrimit të provave të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 20.01.2025, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit, Ramiz Buzhala, akuzuari H T dhe mbrojtësi i tij av. Ardian Desku.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt. 14.01.2025 prokurori i shtetit bëri leximin e aktakuzës, pasi i pandehuri i kuptoi benifitet dhe pasojat e pranimi të fajsisë, gjykata pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklaramit rreth fajësisë, apo pafajësisë, ashtu që i pandehuri, H T, pas konsultimit paraprak të mbrojtësit të tij av.Ardian Desku, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihej në barrë, më vie shumë keq i pandehuri Haki Tahiri ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë, pendohem për veprën e kryer dhe premtom se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të ngjajshme penale, vepra ka ndodhur pa dashje. I pandehuri pas ndodhjes se aksidentiti ka deklaruar se i kam dhënë ndihme mjeksore këtu të dëmtuarit A D dhe V M, me të njëjtit i kam raportet e mira dhe sa kam njohuri te njetiti edhe ne prokurori kan deklaruar se nuk kërkojn ndjekje penale, me vjen keq për rastin e ndodhur edhe tani jam i gatshëm që nëse ka nevoj te ju ofroj shërbime që vlerësohen të nevojshme nga mjeket. Gjatë trajtimit mjekësor te te

dëmtuarve jam interesuar për ta për shëndetin e tyre , kam qenë gjatë gjithë kohës në Spital me ta me qëllim që të ju ndihmoj qoftë moralisht apo edhe financiarisht.

Gjykata kërkon mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush. Pas konsultimit me të mbrojturin e tij , pasi që i njëjti e kupton natyrën e pranimin të fajësisë , pranimin e bënë me vullnet dhe vetëdije të plote dhe pranimi i fajësisë mbetet në fakte që mbështet edhe aktakuza , andaj propozoj gjykatës që të aprojoj pranimin e fajësisë.

Edhe mbrojtësi i të pandehurit av Ardian deskaj deklaron se: meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë, e ka kuptuar veprën penale për të cilën akuzohet e ka bërë pranimin në mënyrë vullnetare dhe në pajtim me shkresat e lëndës , i propozoj gjykatës që të aprovoj këtë pranim fajësisë , ndërsa në momentin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të i marrë parasysh rrethanat lehtësuese të cilat plotësohen që të gjitha nga neni 70 i KPRK-se .

2.Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga i akuzuari i lartcekur, për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 të KPPK-së. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se i akuzuari, ka kryer veprën penale siç e ka pranuar edhe vet, veprën penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4.Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarin, t'a shpall fajtor për kryerjen e veprave penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjyqimit dhe për të njëjtën është përgjegjës. Kjo për faktin se e ka pranuar edhe vet.

5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarës Gjykata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, si dhe pendimin e tij, i njëjti për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, si rrethanë tjetër lehtësuese gjykata muar se i pandehuri, është mbajtës i vetëm i familjës,, dhe nënën e ka të paralizuar i cili kujdeset për te, ashtu që gjykatës i ka premtuar se nuk do ta përsërisë më vepra penale. Si rrethanë posaqerisht lehtësuese muar kujdesin që palëve të dëmtuara u ka dhënë ndihmë menjherë dhe i ka përcjellë qdo ditë gjendjen shëndetësore të tyre gjatë qëndrimit në Spital, e edhe pas, si dhe pajtimin me palën e dëmtuar. Ndërsa, gjykata sa i përket rrethanave rënduese gjykata gjeti pakujdesinë e kryerjes së veprës penale.

6.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Dënimi me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) €uro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguaj në dy rata më së largu gjerë me dt. 05 të muajit vijues, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejt, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjykata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por edhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet u muar konform nenit 452 par. 4 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 242 dhe nenit 365 dhe 370 të KPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.122/2024 me datë 20.02.2025

Gjyqtarja

Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.